



SHFK"Anton Zako Çajupi" f.Hotël

Plan global dhe aksionar për nxënësit me prirje
dhe të talentuar

Matematikë

Klasa e tretë

Koncepti i ri

Viti shkollor 2023/24

Punoi: Mësimdhënësi, Zekirja Latifi

Nxënësi/nxënësja di dhe mund:

Rezultatet e të nxënësve të përcaktuara në programin mësimor çojnë në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të mbuluara nga fusha Matematika dhe Shkencat natyrore nga Standardet Kombëtare:

III-A.1

të përdorë rendin e operacioneve me numra të plotë, thyesa dhe numra decimal, duke përfshirë kllapat;

III-A.2

për të rumbullakuar numrat në një shkallë të caktuar saktësie;

III-A.13

të analizojë forma 3D përmes rrjetave dhe projeksioneve;

Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:

III-B.1

çdokush mund të mësojë matematikë nëse përpiqet mjaftueshëm;

III-B.2

njohuritë e matematikës gjejnë zbatim në shumë fusha të jetës së përditshme;

III-B.3

njohuritë e matematikës janë të nevojshme për marrjen e njohurive nga lëndët dhe disiplinat e tjera shkencore;

Programi mësimor përfshin gjithashtu kompetencat përkatëse nga fushat e mëposhtme transversale të Standardeve Kombëtare:

Shkrim-leximi digjital, Zhvillimi personal dhe social, Shoqëria dhe kultura demokratike dhe teknika, Teknologjia dhe sipërmarrësia.

Nxënësi/nxënësja di dhe mund:

IV-A.2

të vlerësojë se kur dhe në çfarë mënyre nevojitet përdorimi efektiv i TIK-ut për të zgjidhur një detyrë/problem;

IV-A.5

të përcaktojë se çfarë informacioni i nevojitet, të gjejë, përzgjedhë dhe shkarkojë të dhëna, informacione dhe përmbajtje digjitale;

V-A.6

për të vendosur synime për mësimin dhe zhvillimin personal dhe për të punuar në tejkalimin e sfidave që dalin në rrugën drejt realizimit të tyre;

Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:

- IV- shkrim-leximi digjital është i nevojshëm për jetën e përditshme – lehtëson mësimin,
- B.1 jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim;
- V- arritjet vetanake dhe mirëqenia e dikujt varen në masën më të madhe nga përpjekja
- B.3 që investon dhe nga rezultatet që ai arrin;

Plan global për nxënësit me prirje dhe të talentuar	Kl.III-2	2023/24
Përgaditi;Arsimtari Zekirja Latifi	SHFK"Anton Zako Çajupi",f.Hotël	
Modifikoi:		
Fushat e nxënësve të talentuar dhe specifikat e tyre	Lënda Matematikë	
Aftësi specifike	Nxënësit e talentuar Posedojnë aftësi për lëmitë e caktuara hulumtuese,kanë memorje të mirë,janë të informuar nga më shumë lëmi,shpejtë përvehtësijnë dituri dhe shkathtësi,shpejt i zgjidhin problemet,shpejt i kuptojnë përmbajtjet e reja mësimore.	
Aftësi krijuese	Posedon kreativitet dhe pavrësia në marrjen e vendimeve;mendim fleksibil;ide autentike,të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve në mënyrë autentike.	
Aftësi të përgjithshme intelektuale	Posedon: shkallë e lartë e intelgjencës;fjalor të pasur,ide të reja,aftësi për abstaktim;mësimi lehtë i përmbajtjeve mësimore.	
Aftësi artistike	Posedon aftësi të kordinimit motorik,të shprehin ndjenja edhe për muzikën,aktrim,dhe vepra artistike.	
Shkathtësi sociale për udhëheqje	Nxënësit e talentuar marrin pergjegjësi mbi supet e tyre,kan aftësi të marrin vendime,kan pritshmëri të lartë dhe nga të tjerët.posedojnë tendencë për dominim.	
Shkathtësi informatike,teknologjike dhe mediatike	Tregojnë aftësi informatike,gjat punës në projekte duke përdorur Teknologjinë informatike komunikuese.	

Qëllimet	Përmbajtja	Koha e realizimit
-Identifikimi i nxënësve të talentuar përmes plotësimit të listave identifikuese; -Punimi i programeve individuale	Test me iniciale për kontrollimin e njohurive të lëndës së gjuhës shqipe ,dhe caktimi i nivelit të pëparimit.	shtator tetor prill qershor
-Individualizimi mësimi -Zbatimi i formave dhe metodave mësimore bashkëkohore.	Përdorimi i instrumenteve për përcjelljen e shkallës së të arriturave të nxënësve të talentuar.	nëntor dhjetor mars
-Përcaktimi i të arriturave individuale; -Pëmirësimi i të arriturave individuale të nxënësve të talentuar; -Pjesëmarrja në gara,konkurse dhe aktivitete hulumtuese	Pjesëmarrja në gara eksterne dhe interne,në gara komunale,regjionale ose shtetërore,në gara të ndryshme të punës së aktiviteteve jashtëmësimore ose punës së dobishme shoqërore. Pjesëmarrja në aktivitete ekologjike;përdorimi i teknologjisë informative komunikuese.	shtator dhjetor shkurt Mars qershor
Rezultatet e pritura -efektet nga realizim i këtij program janë :Përkrahja e përparimit të nxënësve me prirje dhe të talentuar,përmirësimi i qasjes për punë me nxënës me prirje dhe të talentuar ,mundësimin e përparimit individual në pajtim me prirjen ose talentin ,zhvillimi i qëndrimit pozitiv të nxënësve me prirje dhe talent.		

PROGRAMI PËR NXËNËSIT ME PRIRJE DHE TË TALENTUAR

Mësimdhënësi përmes punës së tij duhet ta njohë dhe ta motivoj zhvillimin individual të nxënësit dhe ta përkrah nxënësin e talentuar.

Faza e parë në punën me nxënës të talentuar është identifikimi i tyre përmes plotësimit të fletava identifikuese.

-Faza e dytë është identifikim i tipit të nxënësit të talentuar.

-Faza e tretë është përpunimi i programeve individuale.

-Faza e katërt është faza e realizimit.

Theksi në programin e punës me nxënës të talentuar duhet të koncentrohet në bazë të methodsve dhe formave të punës mësimore të cilat duhet të orientohen drejt mësimin të pavarur dhe shfrytëzimit të informacioneve, zhvillimit të aftësive, zgjedhja e metodave në koherencë me standardet nacionale, në atë mënyrë që të arrijë deri tek dituritë e reja. Programi do të realizohet përmes;

- Individulizimit të mësimin me nxënësit
- Mësimi grupor i nxënësve me aftësi të përafërta, në orët e rregullta dhe në mësimin plotësues.
- Përmes aktiviteteve projektuese projektuese
- Organizimi i garave ,konkurseve dhe aktiviteteve hulumtuese;
- Organizimi i punëtorive kreative.

Qëllimet;

-Të njihen dhe identifikohen nxënësit sipas talentit të tyre;

-Të zbulohen karakteristikat e nxënësve të talentuar;

-Punë praktike me nxënësit e talentuar dhe orientimi i tyre profesional;

-Përcjellja dhe përparimi i personalitetit të nxënësit;

-Të nxitet motivimi i nxënësve;

-Dhënja e këshillave të prirjeve të nxënësve të talentuar;

-Zhvillimi i aftësive të nxënësve për një ose më shumë regjioneve, përmes zhvillimit të aftësive të tyre, intereseve, motivimi dhe teknika e mësimin;

-Pjesëmarrja në gara të ndryshme;

-Zhvillim i drejtë psikofizik i personalitetit të nxënësit

REZULTATET E TË NXËNIT

Tema: NUMRAT DHE NUMËRIMI

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. numëron, lexon dhe shkruan numrat deri në 1000.
2. krahason çiftet e numrave treshifror dhe përcakton vlerën mesatare të shifrave në numrat treshifror.
3. njeh dhe përdor numrat rendorë të paktën deri në numrin e njëqindtë.
4. grupon numrat çift dhe tek deri në 1000.

Tema: GJEOMETRIA

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. masë dhe vizatoni një segment.
2. përshkruan forma 2D dhe 3D dhe ti përmend ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet tyre.
3. numëroni dhe vizatoni drejtëza simetrike.
4. përcakton pozicionin e një objekti në një rrjet katror dhe i lëviz objektet përgjatë një rrjeti katror.

Tema: OPERACIONE ME NUMRA

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. mbledh dhe zbrit numrat deri në 1000.
2. dyfishon dhe përgjysmon numrat deri në 1000 (dyfishimi nuk duhet të kalojë 1000).
3. shumëzon dhe pjesëton me 2, 3, 4, 5, 6, 9 dhe 10.
4. gjen gjysmën, të tretën, të katërtën, të pestën, të gjashtëm, të tetën, të nëntën dhe të dhjetën e një grupi objektësh deri në 100.

Tema: MATJA

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. llogarit se si të paguajë një shumë të saktë deri në 1000 denar duke përdorur monedha dhe kartëmonedha.
2. përdor njësitë standarde të gjatësisë, masës dhe vëllimit në një kontekst të përditshëm.
3. lexon kohën nga një orë dhe përcakton intervalet kohore.

Tema: PUNA ME TË DHËNAT

1. lexon dhe interpreton të dhënat,
2. mbledh, organizon, prezanton dhe interpreton të dhënat.

Nxënësi/nxënësja do të përgatitet për:

3. planifikimin dhe kryerjen e kërkimeve të thjeshta për një problem të caktuar.

Temat kyçe që do të realizohen në mësimin e rregullt gjat vitit shkollor 2023/24

Plan global për nxënësit me prirje dhe të talentuar		Matematikë Kl.III-2	2023/24
Përgaditi;Arsimtari Zekirja Latifi		SHFK"Anton Zako Çajupi",f.Hotël	
Modifikoi:			
Përmbajtjet (konceptet)	Standardet për vlerësim	Aktivitete	koha e realizimit
Numrat deri 1000 (numri, sasia, shifra)	Numëron numra treshifror përpara dhe mbrapsht nga 1, 10 dhe 100 deri 1000 <ul style="list-style-type: none"> Numëron me dy, tre, katër, pesë, gjashtë, nëntë dhe dhjetë një grup më të madh objktesh deri në të paktën 100. 	Nxënësit, të ndarë në grupe, në tabela deri në 1000, numërojnë përpara dhe mbrapa nga një numër i dhënë dyshifror ose treshifror me 10, me 50, me 100 me 1000.	Shtator
Numrat çift dhe tek	<ul style="list-style-type: none"> Njeh dhe emërton numrat çift dhe tek deri në 1000. Formon një varg numrash për dy më të mëdhenj ose dy më të vegjël se një numër i caktuar deri në 1000. 	Nxënësit në dyshe duhet të formojnë një varg numrash për dy më të mëdhenj ose dy më të vegjël se një numër i caktuar deri në 1000. U jepet një kartë me një numër dyshifror ose treshifror, ata shkruajnë radhazi numra më të mëdhenj ose më të vegjël se dy, duke i renditur ato me radhë.	Tetor
<ul style="list-style-type: none"> Forma 2D (kulmi, brinja, këndi i drejtë, shtatëkëndëshi, tetëkëndëshi, nëntëkëndëshi dhe dhjetëkëndëshi) 	<ul style="list-style-type: none"> Njeh dhe emërton forma 2D. 	Në grupe, nxënësit ngjitin kruese dhëmbësh në një fletë letre duke bërë forma 2D dhe më pas shënojnë kulmet e formave 2D me shkronja.	Nëntor
Pozicioni, drejtimi dhe lëvizja (rreshtat, kolonat, rrjeti katror)	Përcakton pozicionin e një objekti në një rrjet katror me rreshta dhe kolona të shënuara.	Në oborrin e shkollës ose sallën e edukatës fizike vendoset një rrjet katror i shënuar me rreshta dhe kolona. Nxënësit luajnë një lojë: "Lëvizni sipas	dhjetor

		udhëzimeve të dhëna në një rrjet katror të vizatuar", (p.sh. lëvizni 3 katrorë majtas dhe 5 katrorë lart..etj).	
Mbledhja dhe zbritja deri në 1000 (mbledhësi, shuma, zbritësi, i zbritshmi, ndryshimi, vetia komutative).	Mbledh qindëshe deri në 1000. • Mbledh numra treshifror me 100 dhe qindëshe të plota.	• Mësuesi tregon një kartë me një qindëshe të plotë, për shembull 400. Nxënësit duhet ta ngrënë kartën me qindëshe të plotë, për shembull 600, e cila me kartën e treguar nga mësuesi jep një shumë prej 1000	janar
Thyesat (gjysma, $\frac{1}{2}$ një e treta, $\frac{1}{3}$ një e katërta, $\frac{1}{4}$)	Një pjesë të një tërësie modeli. • Shkruan pjesë të një tërësie me thyesë.	Nxënësit punojnë në çifte. Çdo çift ka nga 100 zheton. Duhet të gjejnë për shembull: $\frac{1}{2}$ të 100zhetonve të 60 zhetonëve. Për çdo pjesë të caktuar të grupit të dhënë të sendeve në nivel të klasës ata fitojnë dy të tretat e $\frac{2}{3}$ e 60. zhetonave	shkurt
Paratë (monedhat: 1, 2, 5, 10 dhe 50 denar dhe kartëmonedha prej 10, 50, 100, 200, 500 dhe 1000 denar).	Një dhe emërton monedha dhe kartëmonedha deri në 1.000 denar. • Përcakton shumën e saktë të parave duke mbledhur ose zbritur monedha dhe kartëmonedha.	Nga një qese e errët nxënësit nxjerrin monedha dhe kartëmonedha nga 1 deri në 1.000 denarë dhe e thonë vlerën e tyre (1 denar, 2 denarë, 5 denarë, 10 denarë, 50 denarë, 100 denarë, 500 denarë dhe 1.000 denarë).	mars
Koha (sekonda, minuta, ora, dita, java, muaji, viti, dekada dhe kalendari).	Lexon kohën në orë, minuta dhe sekonda. • Rendit ditët e javës, muajt e vitit dhe vitet në dekada.	Nxënësit në grup zhvillojnë një aktivitet me kompjuter: Gjejnë kalendarët e viteve të mëparshme (p.sh. 2018, 2019, 2021 ose 2022). Në ato kalendarë, nxënësit duhet të gjejnë se në cilën ditë të një viti të caktuar ka qenë ditëlindja e tyre.	prill
Leximi i të dhënave	Lexon të dhëna nga listat, tabelat, piktogramet (me simbole që përfaqësojnë 2, 3, 4, 5, 6, 9 ose 10 të dhëna) dhe diagramet (i Venit, i Kerollit dhe	Nxënësit punojnë në grupe. Secili grup mund të zgjedhë një pyetje për të menduar, p.sh. Cili është libri më i preferuar nga nxënësit e klasës së tretë? Mësuesi/ja u parashtron atyre pyetje: Si	maj-qershor

Shtyllor) të renditura në dy kriterë.

mund ta gjejmë atë që duhet të dimë? Çfarë të dhënash do të mbledhim?

Plan aksionar për nxënësit me prirje dhe të talentuar				
Përgaditi;Mësimdhënësi,Zekirja Latifi		SHFK"Anton Zako Çajupi",f.Hotël		
Modifikoi:		SHFK" "		
Nº	Aktivitetet	resurset/mjetet	Realizoi	koha e realizimit
1.	Informimi dhe njohja e arsimtarëve me prirjen dhe talentin;biseda me arsimtarë klasorë,udhëheqës arsimtarë lëndorë dhe prindër,zbatimi i instrumenteve për identifikim ,përgaditja e programeve individuale për punë me nxënës me prirja dhe të talentuar në aktivitetet jashtëmësimore,	Literaturë profesionale,prezntim e të ndryshme në nivel të ekipit professional. Ekipi për përgaditjen e planit vjetor në shkollë. Dhënia e instrumenteve për identifikim	Mësimdhënësi i klasor ekipi professional Prindër Nxwnwsit e talentuar	Shtator
2.	Identifikimi i nxënësve me prirje dhe të talentuar Përcjellja e programeve individuale për punë me nxënës me prirje dhe të talentuar.	Biseda konsultative profesionale të bazuara në materialin professional nga punëtorja e planifikuar	Mësimdhënësi i klasor Aktivi profesional	Tetor
3.	Dhënja e këshillave Punë konsultative me nxënës,prindër dhe arsimtarë.	Takimi dhe biseda me prindër;Resurse nga TIK,teste,ushtrime ,aktivitete	Arsimtarë klasorë Arsimtarë lëndorë	Nëntor
4.	Informimi i prindërve për nxënësit me prirje dhe të talentuar	Bisedë me nxënësit me prirje dhe të talentuar,literaturë profesionale	Bashkëpunët orë professional	dhjetor

		-Dosie për nxënës me prirje dhe të talentuar	Nxënësit me prirje dhe të talentuar	
5	Puna me nxënës me prirje dhe të talentuar	Resurse nga TIK ,Teste nga ndonjë pjesmarrje në gara komunale	Mësimdhënës i klasorë	janar
6	Biseda këshilldhënëse me nxënësit me prirje dhe të talentuar ,me qëllim të orientimit të drejtë,nxitjes dhe motivimit.	tabela e shpalljes,vebsajti i shkollës;aktivitete të realizuara Brenda shkollës dhe jashtë shkollës	Aktivi profesional mësimdhënës i klasor	shkurt
7	Pjesëmarrje në manifestimet kulturore-shkencore si dhe në gara të ndryshme të gjuhës shqipe	Punë individuale dhe grupore me prindër dhe nxënës	Aktivi profesional mësimdhënës i klasor	mars
8	Dallimi i rezultateve të arritura të nxënësve me prirje dhe të talentuar.	Aktivitete interaktive teste,detyra kontrolluese si në programet kahoot,mentimeter,ëorldë ald etj.	Mësimdhënës i klasorë prindër figura eminente	prill
9	Lëvdrata,për arritjet e nxënësve me prirje dhe të talentuar.	Lëvdata diploma për ariitjet në gara,të ndryshme	Mësimdhënës i klasor	maj-qershor